



# Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"

## Fakulteti i Filologjisë

PROGRAMI MËSIMOR							
<b>Niveli i studimeve</b>	katëvjeçar	<b>Programi</b>	<b>Gjuhë dhe Letërsi Shqipe</b>	<b>Viti akademik</b>	2021-2022		
<b>LËNDA</b>		Filologji shqiptare					
<b>Viti</b>	II	<b>Statusi i lëndës</b>	zgjedhore	<b>Kodi</b>		<b>ECTS kredi</b>	4
<b>Semestri</b>	3	15		Orët mësimore		Ligjërata	Ushtrime
<b>Javët mësimore</b>						2	1
<b>Metodologjia e mësimi</b>	Gjatë realizimit të orës praktikohet metodologjia interaktive, duke e bërë studentin pjesëmarrës aktiv jo vetëm në ushtrime, por edhe në ligjërata						
<b>Konsultime</b>							
<b>Mësimdhënës</b>	Prof. asoc. dr. Xhafer Beqiraj			e-mail	<a href="mailto:xhafer.beqiraj@uni-prizren.com">xhafer.beqiraj@uni-prizren.com</a>		
				Tel.	+383 (0)44 950 - 369		
<b>Asistent</b>				e-mail			
				Tel.			

Qëllimi studimor i lëndës	Përfitimet e studentit
<p>Lënda ka për qëllim që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të marrin njohuri të përgjithshme për zhvillimin e filologjisë shqiptare gjatë evolucionit të saj historik. Njohja e këtij evolucionit të shqipes gjatë shekujve u jep studentëve dije për zhvillimin e kulturës dhe gjuhësisë shqiptare. Nga kjo fushë e dijes do të mësojnë për kontributin e çmuar të shumë albanologëve të huaj dhe dijetarëve vendës në zhvillimin e gjuhësisë shqiptare;</li> <li>- nxitja dhe motivimi për një angazhim sa më gjithëpërfshirës dhe për krijimin e gjykimit personal;</li> <li>- aftësimi për mendime, gjykime, teza e kundërteza;</li> <li>- formimi i shprehive për punë të pavarur interpretuese, krijuese dhe shprehëse.</li> </ul>	<p>Studentët nga kjo lëndë mësimore do të kenë përfitimte teorike dhe praktike. Pikësynim kryesor i lëndës është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojnë drejt rëndësinë e filologjisë shqiptare, zhvillimin historik të saj dhe ndihmesën e filologëve të huaj dhe shqiptarë në studimet e gjuhës shqipe dhe historinë e saj;</li> <li>- përvetësimi i njohurive dhe shkathtësive bazë për zotërimin e gjendjes së strukturës së shqipes në një zhvillim sa më të largët historik, por edhe në nivelin e sotshëm, gjithmonë duke u bazuar në rezultatet e arritura shkencore në këtë drejtim;</li> <li>- bazuar në tezat e kundërtezat e studiuesve të shumtë që do t'i shqyrtojmë gjatë kursit, të aftësohet të gjykojnë edhe vetë në argumentimin ose joargumentimin e këtyre tezave.</li> </ul>

**Metodologjia për realizimin e temave mësimore:**

ECTS-sistemi evropian i transferimit dhe procesi i akumulimit të kredive, është një sistem i orientuar kah studenti dhe paraqet vleftën e ngarkesës së tij për të arritur objektivat e një lënde (kursi) ose programi të caktuar të studimit.

Ngarkesa e studentit sipas ECTS bazohet në kohën që nevojitet për t'i kompletuar aktivitetet e planifikuara rreth një lënde (kursi) siç janë: pjesëmarrja në ligjërata, aktiviteti dhe pjesëmarrja në ushtrime, puna në terren, përgatitja e projekteve dhe plankonspekteve, prezantimet dhe mbajtjet e orëve, punime seminarike, punë konsultative me mentorin, veprimtari eseistike, pjesëmarrja në aktivitetet kulturore (orët letrare, tribunat, performancat), puna e pavarur në bibliotekë ose në shtëpi, përgatitja përfundimtare e provimit, koha e kaluar në provim dhe parametra të tjerë

**Kushtet për realizimin e temës mësimore:**

Tabela, shkumësi, laptopi, projektori, prezantimi, etj.

**Mënyra e vlerësimit të studentit ( në%)**

	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare
	100% - 91%	10 (dhjete)
	90% -81%	9 (nëntë)
	80% - 71%	8 (tetë)
	70% - 61%	7 (shtatë)
	60% - 51%	6 (gjashtë)
	50%	5 ( pesë)

**Obligimet e studentit:**

**Ligjërata**

Studentët kanë për detyrë të ndjekin rregullisht ligjëratat. Në mënyrë ndërvepruese të marrin pjesë në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe t'i kryejnë të gjitha angazhimet që i jep mësimdhënësi.

**Ushtrime**

Studentët kanë për detyrë të marrin pjesë aktive në orët e ushtrimeve. Për çdo paqartësi që kanë me materien e lëndës mësimore, të konsultohen me mësimdhënësin. Gjatë semestrit të bëjnë një punim seminarik, me parapëlqim që ai të prezantohet me Power Point në klasë, të hyjnë në dy paraprovimet dhe së fundmi t'i nënshtrohen provimit përfundimtar.

**Ngarkesa e studentit për lëndën**

Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike	1	10	10
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Punime seminarike	1	3	3
Koha e studimit të pavarur në biblioteka	2	10	20
Detyra të shtëpisë	1	10	15
Projekte, prezantim	1	2	4
Përgatitja përfundimtare për provim	1	4	2
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim përfundimtar)	1	1	1
<b>Vërejtje:</b> Po qe se vlefta e 1 ECTS kredie është 25 orë, atëherë rezulton se për ta përgatitur provimin e lëndës së <i>Filologji shqiptare</i> , studentit i duhen 100 orë pune. Kjo del edhe kur 100 orë pjesëtohen me 25, rezulton se lënda ka vleftë prej 4 kredish.		<b>Ngarkesa totale:</b>	100

Jav a	Ligjërata	Ushtrime
----------	-----------	----------

1.	Tema	O r ët	Tema	Or ët
	Njoftime të përgjithshme për format dhe metodat e punës, qëllimin e lëndës, mënyrën e vlerësimit, udhëzime për punë të pavarur dhe për literaturën e domosdoshme e shtesë	2	Diskutim për zhvillimin e shqipes ndër shekuj	1
2.	Shqipja gjuhë indoeuropiane	2	Diskutime për gjuhët i.e.	1
3.	Vendi i shqipes në rrethin e gjuhëve indoeuropiane	2	Diskutime për shqipen si gjuhë i.e.	1
4.	Shqipja gjuhë ballkanike	2	Diskutim për gjuhët ballkanike	1
5.	Disa tipare të veçanta të gjuhës shqipe	2	Ushtrime lidhur me tiparet e veçanta të shqipes	1
6.	Gjuhët sintetike-analitike (shqipja)	2	Ushtrime Ushtrime	1
7.	Gjuhët analitike-sintetike (anglishtja)	2		1
8.	Testi 1 gjysmësemestral	2	Ushtrime	1
9.	Shtresimi kohësor i fjalorit të gjuhës shqipe (huazimet dhe fjalësi i trashëguar i shqipes)	2	Ushtrime për shtresimin kohësor të fjalorit të gjuhës shqipe.	1
10.	Përpjesëtimi i elementit anas ndaj elementit të huaj	2	Ushtrime - huazimet latine, greke, turke, sllave, rumune etj.	1
11.	Prejardhja e gjuhës shqip	2	Përsëritje e përforsim të materialit të deritashëm	1
12.	Vendi dhe koha e formimit të gjuhës shqipe	2	Diskutime për qëndrimet e disa albanologëve për vendin e formimit të shqipes	1
13.	Rreth periodizimit të historisë së gjuhës shqipe	2	Përsëritje për huazimet dhe kohën kur janë huazuar ato.	1
14.	Testi 2 gjysmësemestral	2	Ushtrime	1
15.	Përmbledhje (përsëritje) e përgjithshme e lëndës në fund të semestrit	2	Ushtrime	1
<b>LITERATURA</b>				

- 1) Demiraj, Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1996.
- 2) Demiraj, Sh., *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, pjesa I dhe II, Prishtinë, 1980.

**Literatura shtesë**

1. Bokshi, B., *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, 2. Prishtinë, 1980.
2. Beqiraj, Xh., *Funksionet semntiko-sintaksore të mbiemrit në gjuhën shqipe*, Mirgeeralb, Tiranë, 2016.

**VËREJTJE**

Nuk do të ketë kurrfarë tolerime për “huazim” nga interneti apo kudo tjetër. Punimet e njëjta apo të ngjashme gjithashtu do të ndëshkohen. Rekomandohet që punimet që dorëzohen të jenë të shkruara me kompjuter.

**Vërejtje për studentin:**

Studentët duhet t’u përmbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së dhe rregulloreve e vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe Këshilli Mësimor.

Pritet që secili student të vijë me kohë.

Nga çdo student pritët që të marrë pjesë në çdo ligjëratë. Për shkak të natyrës dhe mënyrës së mësimin në këtë lëndë, ardhja në mësim dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është e nevojshme (e domosdosë-me). Çdo mungesë e vazhdueshme rezulton me zbritjen e notës përfundimtare. Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t’i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave.